



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Informacion periodik i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit mbi çështjet e regjistruara dhe vendimet

Kolegji i Posaçëm i Apelimit vijon të ushtrojë funksionin e tij në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas paraqitjes së ankimit nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Deri në datën 30 qershor 2024, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka shpallur 259 vendime të Juridiksionit të Rivlerësimit, nga të cilat 12 janë shpallur në vitin 2018, 34 janë shpallur gjatë vitit 2019, 42 gjatë vitit 2020, 38 vendime gjatë vitit 2021, 49 vendime gjatë vitit 2022, 55 janë shpallur gjatë vitit 2023 dhe 29 vendime deri më 30 qershor 2024.

Deri më 30 qershor 2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit janë regjistruar 384 çështje të juridiksionit të rivlerësimit, 40 gjatë vitit 2018, 62 gjatë vitit 2019, 63 çështje gjatë vitit 2020, 86 çështje gjatë vitit 2021, 53 çështje gjatë vitit 2022, 57 çështje gjatë vitit 2023 dhe 23 çështje deri më 30 qershor 2024.

Sa i përket Juridiksionit Disiplinor, deri më 30 qershor 2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit janë regjistruar 21 çështje të këtij Juridiksioni, nga të cilat 2 në vitin 2018, 1 në vitin 2019, 11 çështje gjatë vitit 2021, 2 çështje gjatë vitit 2022, 4 çështje gjatë vitit 2023 dhe 1 çështje deri më 30 qershor 2024.

Deri më 30 qershor 2024, janë marrë gjithsej 18 vendime të Juridiksionit Disiplinor, 9 vendime përfundimtare dhe 9 vendime për moskalim të çështjes në seancë plenare.

Gjatë vitit 2018 janë shpallur 2 vendime: 1 vendim përfundimtar dhe 1 për moskalim të çështjes në seancë plenare; gjatë vitit 2020 është shpallur 1 vendim përfundimtar; gjatë vitit 2021 është shpallur 1 vendim përfundimtar dhe 3 vendime për moskalim të çështjes në seancë plenare; gjatë vitit 2022 janë marrë 3 vendime përfundimtare dhe 4 vendime për moskalim të çështjes në seancë plenare; gjatë vitit 2023 janë marrë 3 vendime përfundimtare dhe 1 vendim për moskalim të çështjes në seancë plenare. Deri më 30 qershor 2024 nuk është marrë asnjë vendim i Juridiksionit Disiplinor.

Për informacion më të plotë, [klikoni këtu](#).